



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË  
KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2019**

**Prishtinë, korrik 2020**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ajtene Llapashtica*, udhëheqës ekipi dhe *Selvete Foniqi*, *Aurora Morina* anëtarë të ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja .....	25
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	27

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të komunës së Kaçanikut për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimit është fokusuar në:



### Konkluzionet

**Konkluzioni për Pasqyrat Financiare** - Pasqyrat Financiare Vjetore ishin në përputhje me rregullat dhe me Standardet e zbatueshme, me përjashtim të keq-klasifikimit të shpenzimeve në mes të kategorive ekonomike. Po ashtu janë vërejtur edhe pasaktësi në shpalosjen e informatave tek pasuritë, LLA dhe detyrimet. Këto janë shtjelluar në detaje në nënkapitujt e veçantë të raportit.

**Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollat** - në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet nuk janë në përgjithësi duke u zbatuar në mënyrë efektive për shkak të dobësive të evidentuara tek menaxhimi i të hyrave, ekzekutimi i pagesave, menaxhimi i pasurive, etj.

**Konkluzioni për zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak** - Përkundër përpjekjeve të komunës për zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak, disa nga rekomandimet përsëritën edhe këtë vit, prandaj nevojiten veprime shtesë për implementimin e plotë të tyre.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm<sup>1</sup>

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## Opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pagesat e realizuara nga Thesari në emër të komunës në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore, në vlerë 153,425€ janë paguar dhe regjistruar në kategoritë jo adekuate ekonomike. Kjo çështje është trajtuar në detaje te nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

## Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Kaçanikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe efektive, mirëpo kërkohet ende përmirësim i mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime janë, zbatimi i rregullave me rastin e planifikimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve, dhe menaxhimi i të hyrave. Me tutje, komuna duhet të ndër marrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e plotë të regjistrave të pasurisë, llogarive të arkëtueshme dhe obligimeve të papaguara

#### 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>8,381,634</b>	<b>8,615,477</b>	<b>8,111,517</b>	<b>94%</b>	<b>7,811,294</b>	<b>6,713,321</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	7,495,209	7,495,209	7,346,664	98%	7,157,204	6,119,690
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	786,413	285,705	258,549	90%	169,558	111,877
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	0	786,413	461,818	59%	374,107	429,039
Donacionet e brendshme	0	6,166	6,005	90%	7,000	0
Donacionet e jashtme	0	2,400	0	0%	84,138	52,715
Huamarrjet	100,012	39,584	38,481	97%	19,286	0

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.



Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 233,843€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak dhe donacioneve, përderisa kishte zvogëlim të financimit nga huamarrja.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final, nivel i njëjtë si në vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	<b>8,381,634</b>	<b>8,615,477</b>	<b>8,111,517</b>	<b>94%</b>	<b>7,811,294</b>	<b>6,713,321</b>
Pagat dhe Mëditjet	5,102,663	5,102,663	4,959,252	97%	4,925,423	4,764,651
Mallrat dhe Shërbimet	900,000	839,594	824,638	98%	870,614	490,400
Shërbimet komunale	160,000	164,500	140,476	85%	63,383	117,200
Subvencionet dhe Transferet	206,540	216,833	215,418	99%	306,772	161,230
Investimet Kapitale	2,012,431	2,291,888	1,971,734	86%	1,645,101	1,179,840

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje nuk kishte pësuar ndryshim në krahasim me buxhetin fillestar;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime kishte pësuar reduktim të buxhetit për 60,406€. Ndryshimet buxhetore ndikoheshin nga fondi i huamarrjes (projekti Shëndetësia Kosovare sipas Marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë), zvogëlim buxheti për 80,182€ dhe rritjet nga të hyrat e bartura 2,941€, donacionet 2,400€ dhe huamarrja nga MASHT 14,434€.
- Buxheti final për shërbime komunale kishte rritje për 4,500€, nga të hyrat e bartura;
- Buxheti final për Subvencione kishte rritje për 10,293€(nga të hyrat e bartura 4,273 dhe donacionet/participimet e bujqëve 6,019€);
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 279,457€. Prej tyre nga të hyrat e bartura 273,990€, nga huamarrja 5,320€ dhe nga donacionet 147€.

---

**Çështja A1 – Keq klasifikimi i shpenzimeve****Gjetja**

Ligji Nr. 06/L -133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike.

Siç kemi paraqitur në paragrafin për Theksimin e çështjes, komuna kishte paguar dhe regjistruar shpenzime nga kategoritë jo adekuate ekonomike. Këto pagesa kanë të bëjnë me:

- Pagesat për investime kapitale, për shpronësim të tokës në vlerë prej 119,872€<sup>5</sup>, të ekzekutuara nga thesari me vendime gjyqësore/përmbartimore nga kategoria Mallra dhe Shërbime; dhe
- Pagesa për paga me vlerë 33,553€, kompensim ndaj punonjësit të larguar padrejtësisht nga puna, dhe ishte paguar nga Investimet Kapitale.

Këto pagesa janë bërë nga kategoritë jo adekuate për shkak të mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

Ne, po ashtu, kemi identifikuar dy pagesa me vlerë totale 6,275€ që kishin të bënin me shpenzimet e varrimit, e të cilat ishin realizuar nga mallrat dhe shërbimet, përderisa natyra e shpenzimeve ishte subvencione dhe transfere. Kjo ka ndodhur si shkak i planifikimit/buxhetimit të mjeteve nga kategoria e mallrave.

**Ndikimi**

Pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate ndikojnë në prezantimin e gabuar të shpenzimeve në regjistra dhe në PFV, duke mbivlerësuar kategori të caktuara të shpenzimeve dhe duke nënvlerësuar kategori tjera.

**Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet me përpikëri sipas kodeve ekonomike adekuate. Po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhet me kohë në mënyrë që të shmangët mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore.

---

<sup>5</sup> Vendimi përmbartimor për këtë rast është në vlerë totale 513,023.63€. Në vitin 2019 janë ekzekutuar 310,809.20€ (keq klasifikimi 119,872€) dhe pjesa e mbetur për vitin 2020; 202,214.43€.

## 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Kaçanikut në vitin 2019 ishin 577,192€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte realizuar 73% të planit të të hyrave.

**Tabela 3. Të hyrat(në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 <sup>6</sup> Pranimet	2017 Pranimet
<b>Të hyrat</b>	<b>786,414</b>	<b>786,414</b>	<b>577,192</b>	<b>73%</b>	<b>584,915</b>	<b>643,910</b>
Të hyrat tatimore	344,874	344,874	293,014	85%	244,907	233,160
Të hyrat jo tatimore	441,540	441,540	284,178	64%	340,008	410,750

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte në vlerë prej 120,348€, prej tyre të hyrat nga gjykatat 3,610€, dënimet në trafik 115,814€ dhe nga agjencia e pyjeve 924€.

### Çështja A2 - Dobësi në dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

#### Gjetja

Ligji nr. 04/L-144<sup>7</sup> për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 5, pika 3 përcakton se dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të ankandit publik, të cilat rregullohen me akt nënligjor.

- Komuna nuk ka procedura të parapara me akte nënligjore për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme komunale. Ndërsa kishte dhënë me qira pronat komunale për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019, duke vazhduar kontratat paraprake pa procedura. Kjo është evidentuar në 4 nga 5 mostrat e testuara. Vlen të ceket se kontratat janë nënshkruar edhe pse qiramarësit nuk kishin kryer obligimet paraprake.

<sup>6</sup> Në tabelë për vitin 2018 dhe 2017 janë të përfshira edhe të hyrat indirekte tek të hyrat jo-tatimore; 86,413€ dhe 142,504€.

<sup>7</sup> Ky ligj ka hy në fuqi në vitin 2012. Ndërsa ligji nr. 06/L-092, i cili ka hy në fuqi në mars 2019, neni 6, pika 1.3 përcakton se komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme për me pak se një (1) vit, procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën deri në një (1) vit rregullohen dhe përcaktohen me rregullore komunale.

Sipas pohimeve të drejtorisë së urbanizmit, këto prona komunale janë dhënë në shfrytëzim që nga viti 1997 dhe kanë vazhduar deri më tani me vazhdim të kontratave.

**Ndikimi** Mungesa e procedurave të shkruara për dhënie të pronave në shfrytëzim afatshkurtër, dëmton parimin e konkurrencës së lirë dhe trajtimin të barabartë të të interesuarve. Vazhdimi i kontratave pa i kryer obligimet paraprake rrit rrezikun e mos inkasimit të të hyrave duke sjell humbje financiare komunës.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të siguroj hartimin e procedurave të shkruara për dhënien e pronave në shfrytëzim afatshkurtër, siç e parasheh ligji. Po ashtu para se të nënshkruhen kontratat e reja të gjithë qiramarrësit/shfrytëzuesit e pronave duhet ti kryejnë obligimet paraprake kontraktuale.

### Çështja B1 - Mangësi në evidencat për pronat me qira

**Gjetja** Sipas nenit 13, pika 3 e Rregullës financiare 03/2010 – Për të hyrat vetanake OB-ja, është e obliguar që ta bëjë barazimin e të hyrave në Thesar. Për tu kryer kjo drejtoritë përkatëse në komunë duhet që të mbajnë shënime të sakta dhe çdo muaj të bëjnë barazimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave.

- Drejtoria e urbanizmit, mban evidencë për pronat e dhëna me qira, mirëpo ato nuk janë të plota për të siguruar se të gjitha vlerat janë regjistruar saktë, pasi që dallojnë të hyrat e regjistruara në freebalance me ato të evidentuara në regjistrin e brendshëm<sup>8</sup>. Po ashtu nuk kishte kartela financiare për pronat e dhëna me qira.

Kjo ka ndodh pasi pagesat e inkasuara përmes përmbauesit privat nuk janë evidentuar në regjistrin e brendshëm, në mungesë të informatave nga zyrtari i të hyrave. Gjithashtu nuk ishin kryer barazimet mujore mes zyrtarit të të hyrave dhe drejtorisë, ku do të mund të evidentoheshin këto mangësi.

**Ndikimi** Neglizhenca e mbajtjes së shënimeve dhe mosbarazimi me zyrtarin e të hyrave ka rezultuar në shënime të pa sakta për qiramarrësit dhe të hyrat si dhe mund të shkaktojë mos inkasim të rregullt të të hyrave.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të siguroj që drejtoria e urbanizmit dhe zyrtari i të hyrave të kryejnë barazime mujore të evidencave. Është e nevojshme që për çdo pronë të lëshuar me qira të mbahen evidenca/kartela financiare.

<sup>8</sup> Në freebalance janë regjistruar 23,553€, ndërsa në regjistrin e brendshëm 18,298€. Diferenca prej 5,255€ mund të jetë për pagesat përmes përmbauesit privat për qiratë të cilat kanë hy direkt në buxhet.

## 2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditjet ishte 5,102,662€, dhe gjatë vitit ishin shpenzuar 4,959,252€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 801 ndërsa në fund të vitit numri aktual i punëtorëve ishte 788. Kemi testuar 40 mostra për teste substanciale si dhe 16 mostra për testim të pajtueshmërisë.

### Çështja C1 - Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta (MShV)

**Gjetja** Sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcaktohet që emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MShV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2019 kishte të angazhuar me MShV 19 punonjës. Edhe pse ishin përdorur procedura të thjeshta rekrutimi, 12 prej tyre ishin nga vitet paraprake kryesisht nga viti 2014. Këto angazhime ishin kryesisht për pozita jo specifike të punës<sup>9</sup>, një dukuri e tillë sipas menaxherit të personelit ka ndodhur për shkak të nevojës për angazhimin e stafit për realizimin e objektivave shtesë të komunës.

**Ndikimi** Mbulimi/vazhdimi i mbulimit të pozitave me MShV përtej afateve të lejuara, është në kundërshtim me normat ligjore, mund të ndikojë në performancë të dobët të stafit si dhe rrit pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.

## 2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet për shërbime komunale) në vitin 2019 ishte 1,004,094€, prej tyre ishin shpenzuar 965,114€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, shpenzimet komunale, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, etj. Kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 197,155€ si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

<sup>9</sup> Mirëmbajtës I hapësirave publike, roje pylli, zyrtar anketues për prona të paluejtshme etj.

---

## 2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 216,833€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 215,418€. Subvencionet ndahen për entitete publike dhe jopublike dhe kryesisht janë shpenzuar për të përkrahur sektorin e bujqësisë, kulturës, shëndetësisë, sportit dhe aktivitete tjera në kuadër të Komunës. Kemi testuar 6 mostra për teste substanciale në vlerë 29,385€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

### Çështja A3 -Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

**Gjetja** Rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve nr.06/2016, neni 8.4 përcakton që "Komisioni i vlerësimit mban procesverbal nga mbledhja e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit, dhe në të cilin përcaktohen kriteret e qarta për subvencionim si dhe mekanizmat se si do të monitorohen dhe menaxhohen subvencionet".

- Te thirrja për aplikim në "Fushën e kulturës rinisë dhe sportit" nuk ishin kërkuar kriteret të matshme dhe specifike për përzgjedhjen e përfituesve potencial. Kjo ka bërë që pothuajse të gjithë aplikantët të plotësojnë kriteret, andaj zyrtarët nuk kanë arritur të na dëshmojnë në tri raste se si është bërë vlerësimi si dhe nuk na janë ofruar procesverbalet nga komisioni për vlerësim siç është e paraparë në rregulloren e brendshme të komunës

Po ashtu neni 13.1 përcakton "Për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet mes komunës dhe përfituesit të subvencionimit".

- Komuna kishte subvencionuar/mbështetur xhirimin e filmit artistik të metrazhit të gjatë "Në kërkim të Venerës" pa marrëveshje paraprake siç kërkohet me rregulloren e brendshme, për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës.

**Ndikimi** Mos përcaktimi i kriterëve specifike me rastin e përpilimit të thirrjeve për aplikim si dhe mos respektimi i kriterëve të rregullores mund të ketë ndikim në trajtim jo të barabartë për aplikuesit. Mungesa e marrëveshjes për subvencionimin shton rrezikun për mos arritjen e objektivave të përcaktuara për subvencionin e dhënë.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të vendosë kontrolle shtesë në procesin e ndarjes së subvencioneve, për të siguruar se kriteret në thirrjet publike për aplikim të jenë specifike dhe të qarta, dhe të sigurohet se subvencionimi paraprihet me marrëveshje e cila bën të mundur edhe monitorimin e shpenzimit të këtyre mjeteve.

## 2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2019 ishte 2,291,888€, prej tyre ishin shpenzuar 1,971,734€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e realizuara për shtrimin e rrugëve lokale, kanalizim, ujësjellës, shpronësime etj. Kemi testuar 46 mostra për teste substanciale në vlerë 815,209€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja A4 - Dobësi në procesin e prokurimit

#### E gjetura

Sipas RrUOPP neni 8.6 i përcaktohet që “Nëse aktiviteti i prokurimit nuk ishte përfshirë në planifikimin final të prokurimit, në rast të autoritetit publik ose ndërmarrjes publike, një kopje e formularit do të dërgohet nga Zyrtari Kryesor Administrativ te Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP) të paktën 5 ditë para autorizimit nga Zyrtari Autorizues të Zyrtarit të Prokurimit për të iniciuar aktivitetin e prokurimit”.

- Gjatë testimit të 5 mostrave të pajtueshmërisë kemi vërejtur se në dy<sup>10</sup> raste komuna kishte zhvilluar aktivitete të prokurimit që nuk ishin të përfshira në planin e prokurimit dhe nuk e kishte njoftuar AQP-në sipas rregullave. Vlen të ceket se për projektin “Ndërtimi i tereneve sportive” punët vetëm kishin filluar dhe nuk ishin realizuar, pasi projekti nuk ishte përfunduar brenda afateve kohore të parapara me marrëveshje dhe kontratë.

Mos përfshirja e këtyre projekteve në planifikim ishte për shkak se projektet kanë qenë bashkëfinancim me ministritë e linjës, përderisa mos njoftimi në AQP ka ndodhur si shkak neglizhencës. Arsyet për mos realizimin e projektit janë problemet e shfaqura në teren, andaj edhe janë ndërprerë punimet.

Poashtu RrUOPP neni 20.10 përcakton “Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues”.

- Në tre projekte për punë<sup>11</sup> komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit vetëm në bazë të paramasës dhe parallogarisë.

<sup>10</sup> “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve të qytetit” bashkëfinancim me MAPL dhe “Ndërtimi i tereneve sportive” bashkëfinancim me MKRS

<sup>11</sup> “Rregullimi i rrugëve në fshatin Kovacevc”, “Ndërtimi i kanalizimeve fekale” dhe “Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Ivajë”

**Ndikimi** Dobësitë e identifikuar në proceset e prokurimit, mungesa e projekteve ekzekutuese, mos njoftimi me kohë në AQP për kontrata jashtë planifikimit ndikojnë në menaxhimin jo të mirë të projekteve, po ashtu edhe vonesave në realizim të tyre.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet jashtë planit të prokurimit do të njoftohen organet kometente, si dhe të përgatiten projektet ekzekutive si pjesë e specifikave teknike të projekteve, në mënyrë që të lehtësohet edhe realizimi i tyre konform kontratave.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV-të e vitit 2019 është 75,573.750€, pasuritë jo kapitale 594,734€, dhe stoqet 1,180€. Kemi testuar 69 mostra për teste substanciale në vlerë 863,717€. Po ashtu kemi vlerësuar procesin e përgjithshëm të menaxhimit të pasurive, inventarizimin e pasurive dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pasurive të komunës.

### Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në PFV

**Gjetja** Rregullorja MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton qartë rregullat dhe procedurat për menaxhimin e pasurive dhe stoqeve. Kjo rregullore kërkon që OB-të të aprovojnë rregulla të brendshme për menaxhimin e pasurive. Po ashtu kjo rregullore përcakton obligimet dhe aktivitetet në lidhje me inventarizimin e pasurive. Gjatë testimit të auditimit kemi evidentuar mangësi të shumta në menaxhimin e regjistrave dhe shpalosjen e informatave në PFV, të cilat janë të shpalosura në vijim:

- Komuna nuk kishte aprovuar rregullore apo procedurë të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare ashtu siç kërkohet me rregullën financiare;
- Komuna kishte formuar komisionin për inventarizim/vlerësim të pasurive, dhe kishte hartuar raportin e përgjithshëm të inventarizimit, mirëpo të njëjtin nuk e kishte harmonizuar me regjistrin kontabël para përgatitjes së PFV-ve;
- Pagesat për shpronësim e tokës<sup>12</sup> nuk ishin evidentuar në regjistrat e pasurisë dhe nuk ishin shpalosur në PFV, duke i nënvlerësuar pasuritë kapitale për 310,809€;
- Te projekti i financuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik "Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje tjera të obligueshme -

<sup>12</sup> Pagesat e realizuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbarrimore.



Programi mbështetës - Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në objektet publike (IV)", i cili ka të bëjë me investime kapitale në dy shkolla në vlerë 40,252€, është bërë edhe zyrtarisht pranim dorëzimi i pasurive, mirëpo këto investime/pasuri nuk janë regjistruar në regjistra dhe nuk janë shpalosur në PFV, duke i nënvlerësuar kështu pasuritë për këtë vlerë;

- Tre (3) kamion të përdorur, të blerë me bashkëfinancim të Komunës, Kompanisë rajonale të Mbeturinave "Pastërtia" dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar sh.p.k (GIZ), me vlerë 45,000€, nuk janë regjistruar në emër të komunës<sup>13</sup>, derisa në regjistrat e pasurive është evidentuar vetëm pjesa e paguar nga komuna (23,000€), duke nënvlerësuar pasuritë kapitale për 22,000€;
- Te pagesa me vlerë 18,628€ për kontratën "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biqec" kemi identifikuar se edhe pse ishte bërë pranimi teknik i punëve, pasuria nuk ishte regjistruar si pasuri në përdorim, por në klasën e investimeve në vijim, duke mos e kalkuluar zhvlerësimin, kjo kishte ndodhë si pasojë e pakujdesisë; dhe
- Vlera e pasurive nën 1,000€ në PFV, është shpalosur sipas raportit të inventarit në përdorim në vlerë 594,734€, e jo sipas raportit të e-pasurisë ku vlera bruto e pasurive nën 1,000€ ishte 329,914€, edhe pse blerjet e pasurive të vitit 2018 dhe 2019 nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria. Përveq kësaj, pasuritë jo-kapitale (llap-top) me vlerë 520€ dhe mobiljet në vlerë 5,000€ nuk ishin regjistruar as në regjistrat e inventarit, derisa me rastin e verifikimit fizik llap topët nuk posedonin as bar kodet.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të vëmendjes së pamjaftueshme ndaj fushës së menaxhimit të pasurive.

## Ndikimi

Mangësitë e identifikuar në menaxhimin e regjistrave të pasurive, kanë ndikuar në shpalosjen jo të saktë të vlerave të pasurive në PFV. Mungesa e procedurave të brendshme dhe mos respektimi i kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive i pamundësojnë menaxhmentit që të ketë në dispozicion informatat e sakta rreth gjendjes së pasurive të komunës dhe kjo e vështirëson marrjen e vendimeve rreth investimeve të mundshme në pasuritë ekzistuese apo vlerësimin e nevojës për investime në pasuri të reja.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të iniciojë aprovimin e rregullave të brendshme për menaxhimin e pasurive për të qartësuar secilin aktivitet që lidhet me menaxhimin e pasurive. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës (përfshirë pasuritë kapitale dhe jo kapitale) janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore.

<sup>13</sup> Sipas Librezeve të regjistrimit kamionët figurojnë në emër të personave dhe firmave private privat, derisa sipas marrëveshjes pronësia e tyre i kalon Komunës dhe Komuna i jep në shfrytëzim tek KRM Pastërtia.

## 2.3 Të arkëtueshmet

Në PFV të vitit 2019, komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 1,464,154€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,194,285€, taksa e bizneseve 237,585€, dhe nga qiraja 32,284€.

### Çështja B3 – Rritje e vlerës së Llogarive të Arkëtueshme dhe shpalosje jo e saktë e tyre në PFV

**Gjetja** Rregullorja nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar neni 16 i obligon organizatat buxhetore që mbledhin të hyra që të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave“.

Në PFV 2019 janë raportuar LLA nga shfrytëzimi i pronës publike vlera 32,284€, mirëpo pjesa e LLA në vlerë 45,966€<sup>14</sup> që janë dërguar tek përmbaruesi për inkasim, nuk ishin shpalosur në PFV. Përveç shpalosjes jo të saktë, informatat për shfrytëzimin e pronës publike nuk ishin të plota dhe kishte gabime në bartjen e salldove<sup>15</sup>. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës, dhe nga mungesa e kordinimit të brendshëm në lidhje me lëndët përmbarimore.

Përveq shpalosjes jo të saktë në PFV, në krahasim me vitin paraprak LLA kanë pësuar rritje për 80,934€. Kjo rritje ishte kryesisht nga tatimi në pronë, i ndikuar nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara/privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit<sup>16</sup>. Megjithatë që nga data 31.12.2019 komuna kishte filluar me aplikimin e masave për inkasim duke dërguar vërejtje për pagesë dhe duke lidhë marrëveshje me tatimpaguesit.

**Ndikimi** Mungesa e shënimeve të sakta të LLA, ndikojnë në pasqyrimin jo të vërtetë të këtyre llogarive dhe shpalosjen jo të saktë të tyre në PFV. Po ashtu mund të ndikojnë në humbjen e të dhënave dhe inkasimin e tyre. Përderisa rritja e LLA nëpër vite, dhe mos inkasimi i tyre, ndikon në përkeqësimin e performancës buxhetore të komunës.

**Rekomandimi B3** Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit.

<sup>14</sup> Për këtë vlerë nuk japim siguri pasi që: - për lokalin afarist në ngastrën 727-0 Kaçanik i vjetër vlera për përmbarim është 2,681€, e njëjta është shpalosur në PFV me vlerë tjetër 3,037€, si dhe për lokalin-zyren në ngastrën 1130-0 Kaçanik vlera për përmbarim është 8,791€, e njëjta është shpalosur në PFV me vlerë 10,891€

<sup>15</sup> Saldo përfundimtare e vitit 2018 në PFV ishte 35,120€. Kjo saldo ishte bartur si saldo fillestare 30,359€ (4,760€ janë më pak). Derisa Saldo përfundimtare për vitin 2019 në PFV ishte paraqitur 32,283€, e në regjistra figurojnë 32,117€. Pas ri-llogaritjes në excel kemi parë se janë 32,504€. (këto diferencë nuk na japin siguri për plotësinë e këtyre shënimeve)

<sup>16</sup> Problemet janë kryesisht me ndërmarrjet e privatizuara që kanë mbet borxh duke iu shtuar kamata dhe interesi. Vetëm borxhi i AKP është me vlerë 111,538€

## 2.4 Detyrimet

### 2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 74,796€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2018 detyrimet e papaguara, të prezantuar në PFV janë rritur për 57,626€.

#### Çështja A5 - Mangësi në prezantimin e obligimeve në PFV

**E gjetura** Rregullorja MF nr.01/2017 për raportim financiar nga organizatat buxhetore, neni 17, pika 3, parasheh se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri me 31 dhjetor të vitit raportues.

- Komuna nuk kishte shpalosur saktë obligimet e papaguara në PFV, duke nënvlerësuar llogarinë për 202,214€, pasi kishte një vendim gjyqësor/përmbarimor të përmbarueshëm<sup>17</sup>, sipas ZKF-së kjo ishte edhe arsyeja e mos shpalosjes.
- Komuna për vitin 2019 nuk kishte libër protokollin për evidentimin e faturave, asnjë nga faturat e testuara nuk ishte e protokolluar.

**Ndikimi** Mangësitë në raportim/shpalosje të obligimeve kanë ndikim në pasqyrimin e drejtë e të saktë të PFV-ve, po ashtu mund të ndikohet zbatimi i projekteve kapitale të parapara për vitin 2020.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të siguroj se të gjitha obligimet e mbetura/papaguara në fund vit të raportohen saktë në PFV.

### 2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 14,309€, e që kryesisht kanë të bëjnë me kompensim dëmi dhe paga jubilarë. Krahasuar me vitin paraprak, këto detyrime kanë shënuar një rënie për 46,891€.

### 2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Komuna nuk na ka ofruar informata në lidhje me vlerën e detyrimeve kontraktuale deri me datën 31.12.2019.

<sup>17</sup> PAGESA TË EKZEKUTUARA NGA THESARI PËR KËTË VENDIM GJYQËSOR/PËRMBARIMOR NË VITIN 2019 ISHIN 310,809€ DHE KANË MBETË DHE JANË EKZEKUTUAR NË 2020; 202,214€

---

## 2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon vetëm me Drejtorin e NjAB-së. Për vitin 2019 ishin planifikuar dhe realizuar pesë auditime të cilat mbulonin fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar si: të hyrat, shpenzimet për mallra dhe shërbime, menaxhimi i projekteve dhe menaxhimi i pasurive. Fokus ishin aktivitetet e viteve 2018 dhe 2019. Po ashtu Komiteti i Auditimit kishte funksionuar me rregull dhe kishte mbajtur takimet e parapara. NjAB në raportet e saj kishte dhënë 23 rekomandime, prej tyre 7 janë zbatuar, 5 nuk janë zbatuar dhe 11 janë në proces.

---

### Çështja A6 - Mos kompletimi i NjAB-së

**Gjetja** Rregullore QRK-nr 01/2019<sup>18</sup> neni 5 pika 1.1 përcakton se “Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7.000.000€) milionë euro të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm. Në komunë NjAB funksionon me vetëm një auditor/Drejtorin e Njesisë.

**Ndikimi** Mos kompletimi i NjAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë në kufizimin e punës për auditimin e të gjitha fushave me rrezik, duke i pamundësuar menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

**Rekomandimi A6** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.

---

<sup>18</sup> Për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik

---

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 kishte rezultuar në 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna kishte dorëzuar në ZKA raportin periodik mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dala nga rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, por jo edhe raportin e dytë përfundimtar.<sup>19</sup>

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 4 rekomandime janë zbatuar; 1 ishte në proces të zbatimit; 3 nuk janë zbatuar ende, dhe 3 rekomandime konsiderohen të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019**

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalesjen e pasurive, regjistrimin e pasurive, dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre. Gjithashtu Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmerinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Nuk janë marrë veprime. Rekomandimi në lidhje me theksimin e çështjes nga viti i kaluar është dhënë tek fusha e pasurive.	Rekomandim i mbyllur
2	Menaxhim i financiar dhe kontrolli	Kryetari duhet të bëj një vlerësim gjithëpërfshirës të shkaqeve të mosrealizimit të buxhetit në disa kategori të caktuara, si dhe të siguroj një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performancës buxhetore në baza të rregullta me qëllim realizimit të buxhetit dhe evitimit të keq deklarimeve.	Komuna për vitin 2019 kishte realizim të mirë të buxhetit	Rekomandim i zbatuar

<sup>19</sup> Raporti i parë i dorëzuar mban datën 22.10.2019, ndërsa raporti që është dashtë të dorëzohet deri me datën 15 mars nuk është dorëzuar.

3	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr masa në rritjen e përgjegjësive të zyrtarit të shfrytëzimit të pronës publike me zyrtarin e të hyrave të cilët janë të obliguar të bëjnë barazimin e të hyrave në baza mujore. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura. Gjithashtu, të krijoj/mbaj një evidencë të qartë dhe të kompletoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas.	Nuk janë Marrë veprime.	Rekomandim i pa zbatuar Ref:B1
4	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj se duhet të respektuar të gjitha kërkesat ligjore lidhur me të punësuarit të rregullt dhe për të punësuarit për shërbime të veçanta	Për të gjitha MSHV, komuna kishte bërë shpallje të konkursit.	Rekomandim në proces të zbatimit Ref:C1
5	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë marrë masa konkrete lidhur klasifikimin e shpenzimeve.	Nuk kemi Identifikua çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
6	Çështjet e përbashkëta për M&Sh si dhe IK	Kryetari duhet të siguroj që procesi i planifikimit të prokurimit të bëhet në mënyrë profesionale, më i saktë dhe përzgjedhja e fituesve të jetë sa më reale	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
7	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë. Po ashtu gjendja e inventarizuar të krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme të identifikohen dhe më pas të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.	Nuk janë Marrë veprime.	Rekomandim i pa zbatuar Ref:B2
8	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të ndërmerr masa lidhur me sigurimin e një softueri i cili do të mundësonte mbajtjen e saktë të evidencës lidhur me llogaritë e arkëtueshme, kategorizimin e tyre	Nuk janë marrë veprime	Rekomandim i pa zbatuar Ref:B3

		sipas vjetërsisë dhe bartjen e saktë të salldove të tyre në vitin në vijim.		
9	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të ndërmerri masa për të shqyrtuar shkaqet për dështim të inkasimeve të llogarive të arkëtueshme dhe të sigurojë mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura dhe të inicioj proces të rivleresimit të llogarive të arkëtueshme, ku të gjitha llogarite do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse dhe mundësive reale për inkasimin e tyre, e në raste të caktuara të bëhet provizionimi apo shlyerja e tyre në rast të kategorizimit si borxhe të këqija.	Komuna ka ndërmarrë masa për inkasim të borxhit, megjithatë ka vlera e larta të LLA në PFV	Rekomandim i mbyllur
10	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari të sigurojë se, plani i NjAB-së të zbatohet një qasje ndaj fushave me rrezik duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim, si dhe një fokus më të lartë të menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.	NjAB kishte planifikuar dhe kishte përfunduar raportet bazuar në fushat me rrezik.	Rekomandim i zbatuar
11	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit, procesi i regjistrimit dhe inventarizimit duhet të përfshinë gjithë pasurinë komunale. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Raportimi menaxherial nuk është subjekt i trajtimit në këtë raport.	Rekomandim i mbyllur.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet me përpikëri sipas kodeve ekonomike adekuate, po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhën me kohë në mënyrë që të shmangët mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore.		

2	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj hartimin e procedurave të shkruara për dhënien e pronave në shfrytëzim afatshkurtër, siç e parasheh ligji. Po ashtu para se të nënshkruhen kontratat e reja të gjithë qiramarrësit/shfrytëzuesit e pronave duhet ti kryejnë obligimet paraprake kontraktuale.
3		Kryetari duhet të siguroj që drejtoria e urbanizmit dhe zyrtari i të hyrave të kryejnë barazime mujore të evidencave. Është e nevojshme që për çdo pronë të lëshuar me qira të mbahen evidenca/kartela financiare.
4	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.
5	Subvencio net dhe Transferet	Kryetari duhet të vendosë kontrolle shtesë në procesin e ndarjes së subvencioneve, për të siguruar se kriteret në thirrjet publike për aplikim të jenë specifike dhe të qarta, dhe të sigurohet se subvencionimi paraprihet me marrëveshje e cila bën të mundur edhe monitorimin e shpenzimit të këtyre mjeteve.
6	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet jashtë planit të prokurimit do të njoftohen organet kometente, si dhe të përgatiten projektet ekzekutive si pjesë e specifikave teknike të projekteve, në mënyrë që të lehtësohet edhe realizimi i tyre konform kontratave.
7	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të inicojë aprovimin e rregullave të brendshme për menaxhimin e pasurive për të qartësuar secilin aktivitet që lidhet me menaxhimin e pasurive. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës (përfshirë pasuritë kapitale dhe jo kapitale) janë regjistruar në regjistra dhe janë shpалosur saktë në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore.
8	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit.
9	Detyrimet e pa paguara	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha obligimet e mbetura/papaguara në fund vit të raportohen saktë në PFV.
10	Funksioni i Auditimit të Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.



---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*



157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër e Konfirmimit

		 REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPSTINA KAÇANIK		
		Data: 21.07.20	Vreth: KAÇANIK	
Nr. org.	Numri	Shtojcë		
01	670/03-164/2	1		

Komuna Kaçanik - Municipality of Kaçanik  
 Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit;  
 Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Besim Ilazi   
 Kryetar i Komunës së Kaçanikut,  
 Data: 21. korrik 2020, Kaçanik,